

NR. PROT 210
28-10-2019

FORMULARI TIP I

Nr. ___ Prot

Date: 28 /10 /2019

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; **Aplikim për Leje Mjedisi të Tipit B.**
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; **Subjekti "ALBA SHOES GROUP" SHPK, Nipt: L21624013A.**
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; **Qarku Tiranë, Bashkia Kamëz, Rruga Tiranë – Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit, Rruga Rilindja, Km.7, Zona Kadastrale 2066, Nr. Pasurie 10/8.**
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; **Prodhimi i kepuceve. (Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, ID 7.12.o. "Prodhimi i këpuceve". Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit. Kapaciteti kufi Leje Mjedisi Tipi B).**
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; **Nuk ka ndikime ndërkufitare.**
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; **Bazuar në Kreun III, të VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, procedura zgjat 40 ditë pune.**
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; **info@akm.go.al.**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Nr.kontakti

(Z. Nikolin Lleshi)

+355 69 70 30 666

Sikola Hoxha

